



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 70, datë 27.07.2022

PËR

MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË KUSHTEVE TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR  
OBJEKTIN: “GODINË POLIFUNSIONALE 13 KATE MBITOKË, ME 3 KATE  
NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “MINE PEZA”, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 17, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Nova Construction 2012” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Të miratojë rishikimin e kushteve të lejes së ndërtimit për objektin: “Godinë polifunkionale 13 kate mbitokë, me 3 kate nëntokë, me vendndodhje në rrugën “Mine Peza”, Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Nova Construction 2012” sh.p.k., miratuar me Vendimin Nr. 10, datë 23.10.2019 të Këshillit Kombëtar të Territorit
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 10, datë 23.10.2019, zëvendësohen me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

**BELINDA BALLUKU**



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

**LEDIA TOTA**

